

VENDIM
Nr.920, datë 2.7.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM,
TË KOMUNËS SINJË TË QARKUT TË BERATIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Sinjë të qarkut të Beratit, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Sinjë të qarkut të Beratit, miratuar me vendimin nr.638, datë 29.9.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Sinjë, të qarkut të Beratit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Sinjë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Sinjë

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-13	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
14-17	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
19-21	Prona që përdoren në fushën e kulturës dhe sportit	Në pronësi
84-88	Infrastrukturë (troje të lira)	Në përdorim
18	Administratë	Në pronësi
22-71	Shërbim funeral	Në pronësi
82-83,89	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
72-81,744-800	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
821-828	Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm (sisteme në administrim të komunës)	Në pronësi
110,140	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të	Në pronësi

	ushqimit (kanale të treta dhe toka jo produktive)	
90-109,111-139,141-145	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim